

Konkluzionet e ekspertit ne këqyrjen e vendit të ngjarjes, burim shkencor për ngritjen e versioneve operative ne zbulimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale

**NGA KOLONEL XHAVIT SHALA
DREJTOR I POLICISË KRIMINALE**

Policia kriminale ne gjithë veprimtarinë e saj ka për mision zbulimin, parandalimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e veprimtarisë kriminale. Pavarësisht nga natyra e krimit, policia heton te gjithë etapat e kryerjes se tij dhe ne mënyre komplekse merr masa për te bere te mundur dokumentimin ligjor te çdo vepre penale.¹

Ngjarjet kriminale mund te jene te ndryshme, si ato qe ndiqen me ankim , - kur personi i dëmtuar ankohet pranë organit te policisë për kryerjen e ne vepre penale,- me kallëzim, kur një person fizik ose juridik denoncon për një vepër penale qe është kryer ose është duke u kryer dhe ngjarjet kriminale me vendngjarje.

Vendi i ngjarjes mund te jete një territor ose lokal i caktuar ne një kohe te dhëne, i cili ne krahasim me gjendjen e tij te mëparshme ka pësuar ndryshime. Nga ana kriminalistike, ngjarje konsiderohen vetëm ato qe shoqërohen dhe pasohen me lëvizjen e sendeve apo objekteve, me thyerje e dëmtime te tyre, pra ato qe sjellin ndryshime me pasoja dhe lënë gjurme materiale.

Ne këto raste oficeret e policisë gjyqësore kryejnë një sere veprime paraprake, si marrjen e njoftimit për veprën e kryer, verifikimin e tij, ruajtjen e vendit te ngjarjes, formimin e grupit hetimor, pajisjen me mjete teknike e kriminalistike etj. Mbas marrjes se këtyre masave fillon këqyrja e vendit te ngjarjes.

Këqyrja mund te jete e drejtpërdrejte ne momentin mbas kryerjes se krimit, por mund te ketë dhe këqyrje për krime qe kane ndodhur kohe me pare dhe qe lind e domosdoshme këqyrja e sendeve dhe objekteve qe kane shërbyer si mjet ose si objekt i kryerjes se krimit.

Këqyrja e vendit te ngjarjes është një veprim i patjetërsueshëm dhe i paperseritshem. Si i tille ka rendësi te madhe për zbulimin, parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale. Kryerja e këqyrjes me kujdes, gjetja, përpunimi, marrja dhe fiksimi i provave materiale ka rendësi te madhe për futjen ne rruge te drejte te hetimit për zbulimin e ngjarjeve. Pavarësisht se veprimet për këqyrjen e vendit te ngjarjes nuk tregon autorin si mund te bëjnë dëshmitaret ose

¹ Kjo kumtese është mbajtur ne Konferencën e IV Kombëtare të Shkencave Ligjore, zhvilluar ne Tirane me 2-3 Nëntor 1999.

mjetet filmike, por gjate këqyrjes përcaktohen shume detaje, te cilat edhe syri i dëshmitarit ose sekuencat filmike nuk mund ti kapin ,(për nga rëndësia del si veprim i pa zevendesueshem)

Megjithëse jo gjithmonë veprat penale mund te kryhen ne vende publike dhe ne prani te dëshmitareve, me ane te këqyrjes se vendit te ngjarjes dhe administrimit te provave materiale te gjetura, policia kriminale orientohet dhe ngre versionet e mundshme për autoret e veprës penale.

Ashtu sikurse veprat penale janë te ndryshme, edhe këqyrjet janë te llojeve te ndryshme. Duke filluar nga vrasjet, vjedhjet me dhune, vjedhjet me arme, përdhunimet, djegiet, aksidentet automobilistike, falsifikimi i dokumenteve dhe letrave me vlere , vendosja e eksploziveve etj,te gjitha i nënshtrohen këqyrjes.

Është pikërisht ky veprim i rëndesishem hetimor qe shërben si baze për te përcaktuar vendin e ndodhjes se kriminit, mjetet e përdorura, drejtimin e përshkruar nga autoret për te shkuar ne vendin e kriminit dhe drejtimin e largimit.

Nëpërmjet këqyrjes se vendit te ngjarjes, inspektorët e policisë kriminale krijojnë ide te qarte për mekanizmin e ndodhjes se kriminit. Duke grumbulluar provat materiale te gjetura, paraprakisht krijohet përfytyrimi për ngjarjen e ndodhur. Kjo faze, kur shoqërohet dhe me veprime te tjera operative si marrje te informacionit ne rruge te ndryshme dhe pyetja e dëshmitareve okulare, bën te mundur hedhjen ne dore te provave ligjore për autoret e kriminit.

Ne kuadrin e thellimit te punës gjurmuese hetimore, nga oficerët e policisë gjyqësore, ngjarjet e ndodhura nuk merren si te veçanta, por ato shikohen ne kompleks edhe me ngjarjet e tjera te ndodhura me pare dhe behet lidhja logjike për ngjarjet e për rrjedhoje behet edhe lidhja me prova ligjore e shkencore midis dy ose me shume veprave te kryera.

Kjo ngjashmëri konsiston ne mekanizmin e kryerjes se kriminit, mjetet e përdorura nga autoret, kohen dhe mënyrën e realizimit te kriminit. Njohja e mire e situatës kriminale ne zone, shkuarja ne vendngjarje e oficerëve te policisë gjyqësore, vlerësimi i tyre dhe administrimi shume i mire i provave materiale, bën qe te ngrihen versione bindëse për autoret e veprës penale.

Ngritja e versioneve, verifikimi ne mënyre serioze dhe sistematike e tyre, bën qe ngjarjet te zbulohen dhe veprimtaria kriminale te dokumentohet.

Aktualisht ne te gjithë territorin e vendit, lufta kundër kriminit është ngritur ndjeshëm. Janë goditur shume grupe kriminale dhe është bere dokumentimi ligjor i veprimtarisë se tyre. Megjithëse dosjet hetimore te çelura për veprat kriminale te kryera, jo gjithmonë janë kompletuar me veprime te tjera ligjore, përsëri si rezultat i një pune intensive zbuluese dhe hetimore, është arritur te dokumentohen veprat e kryera.

Rezultatet e arritura nuk janë rezultate rutine, por pune gjurmuese e studiuar, vlerësim maksimal i versioneve te ngritura, verifikim i çdo te dhëne që ka çuar në dokumentimin e veprimtarisë kriminale. Këtu mund të përmendim rastin e goditjes së dy bandave kriminale në Gjirokastër, ku u desh një pune disa mujore deri në dokumentimin dhe hedhjen në dorë të provave materiale, objekt fajësie. Rasti i goditjes së tre bandave në rrethin e Durrësit, ku megjithëse secila bande kishte një numër të konsiderueshëm personash, për të gjithë u grumbulluan prova materiale të plota për dokumentimin e fajësisë së tyre.

Po kështu përmendim rastin e goditjes së bandës së Lushnjës, ku nga Drejtoria e Policisë Kriminale, ishte bërë një pune paraprake e studiuar për dokumentimin e krimeve të kryera prej kësaj bande në një periudhë kohore gati 3 vjeçare.

Te gjitha këto realizime nuk janë të rastësishme, por rezultat i një pune intensive. Janë studiuar dosje hetimore për ngjarjet e ndodhura, janë vlerësuar veprimet e kryera, janë bërë këqyrje e rikeqyrje, të cilat kanë përcaktuar fizionominë e mënyrës së kryerjes së krimit. Sipas informacioneve të marra nga policia kriminale dhe versioneve të ndryshme të ngritura për autorët e grupautoresh, ka bërë që të kryhen krahasime konkrete e masive me provat materiale të gjetura në vendet e ngjarjeve. Pas gjithë kësaj pune të mundimshme edhe rezultatet nuk kanë munguar.

Si rezultat i një këqyrje të kujdesshme në momentin e kryerjes së krimit, marrja dhe administrimi sipas Kodit të Procedurës Penale i provave materiale të gjetura në vendin e ngjarjes, i hapi dritë policisë kriminale të rrethit të Durrësit që të bënte lidhjen midis disa ngjarjeve kriminale të cilat i përkisnin pikërisht një grupi kriminal. Informacionet e marra dhe veprimet operative të kryera, bënë që të goditej grupi i Leonard Muratit i përbërë prej 12 personash. Nga puna e kryer me profesionalizëm e duke u mbështetur në provat materiale të gjetura dhe të administruara me kujdes në vendin e ngjarjes, duke u fiksuar që nga njollat e gjakut, fijet e flokut, gjurmët e lëna në vendngjarje, krahasim i gëzhojave etj, u zbulua vrasja e Myftar Gjones, Muhamet Alushit dhe 11 ngjarjeve të tjera të kryera nga ky grup kriminal.

Gjithashtu mund të përmendim kapjen e bandës së Nehat Kulles, ku si rezultat i një pune të studiuar të policisë kriminale, janë zbuluar ngjarje të kryera që nga viti 1997, si goditja dhe plagosja e 5 policeve të Briskut. Ishte pikërisht këqyrja e kujdesshme e bërë në vendin e ngjarjes, e cila bëri që policia kriminale të vihej në kërkim për gjetjen e armeve, me të cilat ishte kryer krimi.

Nga analizat e shpeshta të bëra nga Drejtoria e Policisë Kriminale, është vërejtur se gjatë vitit 1997 – 1998, kanë ndodhur shumë ngjarje të rënda kriminale, për të cilat sot dalin të dhëna, por si rezultat i punës së pamjaftueshme të oficerëve të policisë gjyqësore në kohën e ndodhjes së ngjarjeve, ka bërë që dokumentimi i tyre të vështirësohet shumë e deri në mos zbulimin e tyre. Në shumë ngjarje nuk janë bërë fare këqyrje të vendngjarjes, nuk janë administruar fare prova

materiale dhe ne disa raste nuk jane evidentuar as si ngjarje. Te tilla raste mund te përmendim ne Tropojë, Vlore, Berat e Lushnje.

Nga informacionet qe ka marre Drejtoria e Policisë Kriminale, janë bere disa goditje, për te cilat është dashur te kryhen veprimet hetimore nga fillimi, ku krahas marrjes se deklarimeve nga shtetas te ndryshëm për veprat penale te ndodhura e te pa evidentuara nga Komisariatet e Policisë, kapjes se autoreve te këtyre veprave penale, është bere një pune e mire ne dokumentimin e fajësisë se tyre. Për ketë janë bere disa eksperimente hetimore qe përputhen me mekanizmin e kryerjes se krimi, me ane te informacioneve te grumbulluara është insistuar ne gjetjen e mjeteve te krimi dhe vendosjes ne pozita pohuese te autoreve.

Faza ne te cilën është aktualisht policia kriminale ne gjithë vendin, gjykojmë se është faze e veprimit te saj ne mënyre te kualifikuar. Dhënia e attributeve te oficerit te policisë gjyqësore, ju ngarkon detyrën qe krahas veprimeve operative, te kryejnë edhe veprime ligjore te papërsëritshme. Gjithashtu, shkuarja ne mënyre te detyruar e Prokurorit ne vendin e ngjarjes, ka bere qe krahas kryerjes ne mënyre te kualifikuar te veprimeve te para procedurale, te ngrihen versione te përbashkëta për zbulimin e ngjarjeve. Pra përfshirja me ligj i këtyre dy organeve ne veprimet procedurale, patjetër ndikon ne dokumentimin cilësor te veprave penale te kryera.

Kjo ishte një pune e nisur, e cila me gjithë veshtiresite e krijuara nga vitet kur policia nuk ka funksionuar me gjithë kapacitetin e saj, përsëri është vene ne pozita te shëndosha pune. Kualifikimi i vazhdueshëm profesional e juridik i efektiveve te policisë kriminale, do te beje qe edhe ne te ardhmen, treguesit e punës dokumentuese e gjurmuese te shënojnë rritje të mëtutjeshme.